



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 1403 / Prot. 1

Tiranë, më 27. 2. 2023

UDHËZIM

Nr. 6, datë 27 2 2023

**“PËR ZHVILLIMIN E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE TË
ARSIMIT FILLOR, VITI SHKOLLOR 2023”**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26, nenit 50, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Zhvillimin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor më datë 22 Maj 2023, për të gjithë nxënësit e klasave të pesta.
2. Testi është i integruar dhe përfshin lëndët gjuhë shqipe, matematikë dhe dituri natyre.
3. Për nxënësit e pakicave kombëtare greke dhe maqedonase pjesa e testit që përfshin lëndët e matematikës dhe diturisë së natyrës të jetë në gjuhën e tyre amtare.
4. Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të arsimit fillor, fillon në orën 10.00 dhe zgjat 1 orë e 30 minuta.
5. Nxënësi duhet të paraqitet 1 (një) orë përpara në qendrën ku zhvillohet testi.
6. Procedurat e hartimit dhe të vlerësimit të testeve përcaktohen në Rregulloren “Për procedurat e organizimit dhe të zhvillimit të vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor”, miratuar me urdhrin nr. 78, datë 27.02.2020.
7. Nxënësit me aftësi të kufizuara e zhvillojnë vlerësimin e arritjeve në përshtatje me programin mësimor me të cilin punojnë, veçoritë dhe nevojat e tyre.
8. Instituti i nxënësve që nuk shikojnë tërheq testin në Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QShA), një ditë para zhvillimit të vlerësimit dhe e kthen atë në sistemin e shkrimit Brail.
9. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, (DPAP) monitoron procesin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor dhe raporton për çdo parregullsi të vërejtur gjatë zhvillimit të tij.
10. Arkivimi i testeve bëhet pranë Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar.

11. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar merr nga Qendra e Vlerësimit të Testit dhe ruan të dhënat e çdo nxënësi, të vlerësuesve të jashtëm dhe të mjediseve ku është realizuar vlerësimi i arritjeve të nxënësve të arsimit fillor. Këto të dhëna dërgohen në QShA, në DPAP dhe në Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar.
12. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Arsimin dhe Sportin, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjensia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR

EVIS KUSHI

